

VENDIM
Nr.5, datë 2.2.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY-AL” SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9, nenit 13, pika 1 germa “ç”, dhe nenit 45, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “f”, nenit 5, pika 1 germa “f”, neneve 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Supply-Al” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Supply-Al” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Supply-Al” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta